

# Ditari Naturës

"Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC Shqipëri në kuadër të programit SENIOR-A "Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri". Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze"  
Nr. 28 Viti i tretë i botimit Shtator 2015

## Në këtë numër do të gjeni:

- ... me këtë rast Ju kujtojmë se ...
- Drejt menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të natyrës dhe zonave të mbrojtura me pjesëmarrje të gjërë
- Filloi hartëzimi i shtigjeve në ZMD Karaburun-Sazan
- Njoftime

## ... me këtë rast Ju kujtojmë se 18 vjet më parë ...

...bazuar në dispozitat e ligjit nr. 8906, datë



Pamje e brendëshme e Shpellës së Jezinës © B.Hallaci

06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin **nr. 451, datë 16.09.1993** "Për mirëadministrimin e shpellave". Sipas këtij vendimi "Shpellat e eksploruara dhe ato të pa eksploruara në territorin e Republikës së Shqipërisë mbrohen dhe administrohen nga shteti, sipasuri natyrore kombëtare". Ish-Komiteti i Ruajtjes dhe i Mbrojtjes së Mjedisit është institucioni i caktuar për kontrollin e shpellave.

Me VKM nr.365, datë 10.07.1995 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.451, datë 16.09.1993 "Për administrimin e shpellave" u caktua dhe "Tarifa e shërbimit (dhënie liçence dhe informacion) për ekipet e huaja deri në 10 veta dhe me periudhë eksplorimi të shpellave deri në 15 ditë caktohet në masën 50 USD. Për grupe më të mëdha se 10 veta ose me periudhë eksplorimi më të gjatë se 15 ditë, vlera e mësipërme dyfishohet."

Me këtë rast Ju kujtojmë se me VKM nr.807, datë 04.12.2003 "Përcaktohen rregullat për dhënien në përdorim të shpellave për t'u vizituar, për qëllime shkencore, ekologjike, kulturore, historike, turistike, kurative, didaktike e fetare duke u kujdesur që të mos dëmtohen vlerat e tyre".

AKZM me strukturat e saja të vartësisë, ka detyrë dhe duhet të drejtojnë vëmendjen dhe të jetë më e kujdesshme në evidentimin dhe marrjen e masave për njohjen, ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e kësaj pasuri me vlerë të lënë në harresë dhe shumë pak e njohur për vendin tonë.

## Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE CAJUPI  
Bashkejto me Natyrën



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT  
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore  
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



SWEDEN

## Drejt menaxhimit të qëndrueshëm shumë funksional të zonave të mbrojtura me pjesëmarrje të gjërë

**Nga Nihat Dragoti / INCA**

Më 28 Korrik 2015, në sallën Tetua, Tirana International Hotel, u mbajt Konferenca Kombëtare



“Sfidat e Menaxhimit të Qëndrueshëm e Shumëfunktional të Natyrës e Zonave të Mbrojtura”. Konferenca u organizua nga Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës (RrMN) në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM). Në të morën pjesë përfaqësues të MM, AKZM, UNDP, REC Albania, ECRAN (BE), përfaqësues të Administratave të Zonave të Mbrojtura (AdZM) të qarqeve, të shoqërisë civile, etj.

Konferenca u mbajt në kuadër të zhvillimeve të reja për zonat e mbrojtura të Shqipërisë, rikthim i vëmendjes nga qeveria, partnerët dhe palët e interesuara për ruajtjen e natyrës, nëpërmjet zbatimit të masave të menaxhimit efektiv të rrjetit të Zonave të Mbrojtura (ZM) në Shqipëri; të krijimit dhe funksionimit të RrMN; krijimi i strukturës së nevojshme të administrimit e menaxhimit të tyre: AKZM dhe AdZM në nivel Qarku si dhe fillimi i procesit të Rrjetit Natura 2000.

Konferenca synoi të sillte në një tryezë të përbashkët përfaqësuesit e ZM-ve (stafet e ZM-ve dhe përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit (MM) dhe grupet e interesit që punojnë në mbrojtjen e natyrës apo kryejnë aktivitete sociale-turistike në ZM, përfaqësues të pushtetit vendor, donatorë dhe dashamirës, për të diskutuar dhe analizuar arritjet e deri sotme, mangësitë e pengesat dhe çfarë duhet të bëjmë aktualisht e për të ardhmen.

Siç dihet, ZM-të kanë një rol në rritje, si një strategji për të mbrojtur pasuritë natyrore kombëtare dhe të rajoneve, mbështetës të komuniteteve për përmirësimin e cilësisë së jetesës, rritjen e të ardhurave dhe ruajtës të trashëgimisë natyrore. Sfida për administrimin dhe menaxhimin e tyre është e përbashkët, por përgjegjësit institucionale janë të MM dhe AKZM, të cilat duhet të jenë më të hapura me shoqërinë civile, pasi synimet dhe përfitimet janë të njëjta.

Ndonëse e re AKZM po punon për kristalizimin e programit të saj të punës, për krijimin dhe funksionimin e AdZM-ve në qarqe, për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe forcimin e kapaciteteve të strukturave administruese dhe monitoruese për një zbatim më të mirë në praktikë të kuadrit ligjor dhe të programeve të menaxhimit efektiv. Njëherazi AKZM është duke hartuar një strategji kombëtare veprimi, e cila do të përmbajnë planin financiar dhe planin e monitorimit, në bashkëpunim me 12 drejtoritë rajonale, për menaxhimin e ZM-ve.



Në këto procese, arritje për t'u shënuar është edhe mbështetja e donatorëve të ndryshëm si: EU, UNDP, WB, GEF, KfW, JICA, IUCN, RAC/SPA, WWF etj, si në zhvillimin e Rrjetit të ZM-ve të Shqipërisë, në përafrimin e legjislacionit dhe hartimin e strategjive e të politikave kombëtare, por dhe në përshtatjen e standarteve në konsolidimin e administrimit dhe hartimin e planeve të menaxhimit për ZM-të. Ndër të tjera veçojmë se një numër i konsiderueshëm i ZM-ve, rreth 12 prej tyre me sipërfaqe 319 mijë ha

### *Vijon nga faqe 2*

ose 69.4%, kanë plane menaxhimi dhe 8 të tjera, me sipërfaqe 107 mijë ha ose 23.3 %, kanë plane menaxhimi në proces miratimi. Një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim ka dhënë INCA dhe RrMN si në rastin e hartimit të Planit të Menaxhimit për PKD “Karaburun-Sazan”, për ZM “Gjiri i Porto Palermos-Llamani”, në studimin, shpalljen dhe hartimin e planit të menaxhimit për Parqet Natyror Rajonal (PNR) të “Liqeni i Ulzës”, “Nikaj-Mërtur”, “Shkrel”, “Kthjellë”, “Zagori” etj.



Parku Kombëtar Theth © Foto INCA

Zbatimi në praktikë i planeve të menaxhimit të ZM-ve, të përpiluara me ndihmën e donatorëve, mbetet një nga synimet kryesore të institucioneve që merren me ZM-të. Por puna në këtë drejtim është për të dëshiruar, është bërë shumë pak për të mos thënë aspak për zbatimin e planeve, kjo tregon se gjendja duhet të ndryshojë rrënjësisht.

Mjaft i rëndësishëm mbetet procesi që lidhet me vlerësimin e vlerave dhe përfitimeve nga ZM-të, qofshin ato ekologjike, sociale, historike, tradicionale apo shpirtërore. Po kaq e rëndësishme mbetet përfshirja e palëve të interesuara si mjet i domosdoshëm për menaxhimin efektiv të ZM dhe veçanërisht të komuniteteve brenda apo dhe rreth tyre, duke zhvilluar: “Veprimtari të qëndrueshme ekonomike, sociale dhe ekoturistike të ballancuara me ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit”.

Procesi i marrëdhënieve dhe i komunikimit me publikun dhe me palët e interesuara për ruajtjen, promovimin e vlerave dhe të rëndësishme të ZM-ve ka qënë i mangët si në zbatimin e ligjit, përgatitjen e materialeve promovuese dhe në drejtim të bashkëpunimit me shoqërinë civile, OJF dhe aktorët lokal. Aktualisht, me disa investime të thjeshta, por

edhe me preokupim të stafit të ri të AdZM-ve, ka një ecuri të mirë në këtë drejtim, kryesisht në promovimin e ditëve të ZM-ve apo festave popullore, të cilat duhet të thellohen e të shtrihen më gjërë. Puna me median ka filluar të përmirësohet dhe duhet të mbetet sfidë për AKZM dhe strukturat e saj.

ZM nuk mund të funksionojnë pa njerëzit që jetojnë brenda apo përreth tyre. Menaxhimi efektiv i ZM nuk mund të kuptohet pa pjesëmarrjen aktive të tyre, të gjithë aktorëve dhe të shoqërisë civile. Në këtë aspekt vërehet dhe është për të ardhur keq, sipas disa sondazheve të REC, që banorët apo dhe biznese të ndryshme nuk e njohin ZM edhe pse janë pjesë dhe jetojnë brenda tyre.

Në menaxhimin e ZM duhet shtuar më shumë ndërgjegjësimi lidhur me konceptin e qëndrueshmërisë, njohjes dhe mirëmbajtjes së tyre. Brenda ZM mungojnë qendrat e informacionit dhe informacioni mbi biodiversitetin për publikun. Vlerat e biodiversitetit janë të përshkruara në dokumentet të cilat përgatitjen për propozimin e ZM a në planet e menaxhimit, por që nuk janë të dukshme për publikun dhe përdoruesit e burimeve natyrore. Shoqëria Civile është e rëndësishme, jo vetëm të japi kontribut në ruajtjen dhe menaxhimin e ZM, por edhe në interpretimin e saktë të informacionit mbi ZM tek grupet e interesit dhe turistët.



Nga ceremonia e përirimit të PNR Kthellë © Foto INCA

Kësisoj ZM nuk shikohen si qendra edukimi dhe komunimi, pasi shkollat nuk janë bërë pjesë e vizitave të tyre. Në këto kushte është e rëndësishme të rikthehen forma të ndryshme të edukimit të brezit të ri, nëpërmjet krijimit të grupeve të natyralistëve të rinj, vizitave, ekskursioneve, shëtitjeve e aktiviteteve në natyrë, konkurseve, panaiereve, festave popullore,

### Vijon nga faqe 3

dokumentarëve, filmave, reportazheve etj, si dhe krijimit të infrastrukturës me mendësi të reja për edukimin dhe komunikimin.

Kjo është një mangësi e punës së më parshme, por që nuk duhet të vijojë përsëri me mendësitë e të shkuarës. Ndryshimi thelbësor i kësaj situatë kërkon një filozofi tjetër në marrëdhëniet me banorët, pronarët, komunitetin e biznesit, median, OJF, shoqërinë civile etj, nga AdZM, të gjithë administratorët, investitorët apo donatorët që financojnë projekte për përmirësimin e gjendjes së ZM apo të krijimit të infrastrukturës e të llogjistikës së nevojshme, etj.



Koncepti i Parkut Natyror Rajonal (PNR) lindi si një iniciativë e shoqërisë civile, i konkretizuar me shpalljen e Liqenit të Ulzës, Nikaj-Mërturit, Shkreli, Kthjellë, Zagori etj. Menaxhimi i PNR-ve kërkon bashkëpunimin dhe miratimin të pushtetit vendor dhe të banorëve, të cilët janë përdoruesit kryesor për menaxhimin e parkut dhe njëkohësisht respektimin e traditave dhe kulturës lokale. Pjesëmarrja e komunitetit lokal është një pikë kyçe për mbështetjen e këtij procesi. PNR duhet të shikohen si mundësi të mira zhvillimi, të përmirësimit të jetesës dhe integrimi ekonomik mbi parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Po kështu si një mundësi të prodhimit dhe shitjes të produkteve mbi bazën e “Branding”, të cilat do të kenë një çmim dhe cilësi më të mirë se në zonat përreth. Disa prej praktikave të mira menaxhuese janë promovimi i mirë lokal dhe kombëtar, ruajtja e traditave dhe zakoneve lokale dhe shndërrimi i tyre në vlera të shtuara, ruajtja dhe mirëmbajtja e vlerave natyrore.

Veç kësaj, Shqipëria ndan shumë prej vlerave

natyrore me fqinjët e saj. Kësisoj, bazuar në përvojën e mirë të fituar deri më tani si me projektet e zhvilluar apo ato në proces për RNM “Liqeni i Shkodrës”, PM “Lumi i Bunës-Velipojë”, PK Ndërkufitar “Alpet e Shqipërisë”, PN “Korab-Koritnik”, PK “Shebenik-Jabllanicë”, PM “Liqeni i Ohrit”, PK “Prespa” etj., është më se e nevojshme që të forcohet bashkëpunimi ndërkufitar dhe pse jo edhe më gjërë se rajonal, në drejtim të menaxhimit të ZM dhe ruajtjes së natyrës në përgjithësi si në rastin e projektit “Parqet e Harkut Dinarik”.

Është mjaft i rëndësishëm fakti që ende shumë donatorë dhe organizata të tjera ndërkombëtare kanë interes për të punuar dhe mbështetur ruajtjen e natyrës dhe përmirësimin e menaxhimit të ZM në Shqipëri. Puna dhe mbështetja e deritanishme ka krijuar një sërë shëmbujsh dhe eksperiencash të vlefshme që duhen përdorur e forcuar më tej.

Sfida për të ardhmen, veç përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga direktivat dhe rekomandimet e BE-së (krijimi i Rrjetit NATURA 2000), është ngritja dhe fuqizimi i strukturave funksionale të menaxhimit të ZM, duke punuar njëkohësisht edhe për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të menaxherëve të ZM, për të siguruar një menaxhim efektiv të tyre. Financimi i qëndrueshëm i ZM duke eksploruar një gamë të gjërë alternativash mbetet gjithashtu një sfidë e vështirë.



Sapo ka nisur nga puna projekti “Financimi i kapaciteteve kombëtare për ruajtjen e natyrës-përgatitja për rrjetin Natura 2000”, financuar nga Komisioni Evropian dhe zbatuar nga Cooperazione Italiana, Ministria e Punëve të Jashtme dhe

#### *Vijon nga faqe 4*

Bashkëpunimi Ndërkombëtar i Italisë, në partneritet me Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) dhe Shoqatën e Botanistëve të Italisë (SBI). Në këtë drejtim jemi të gatshëm dhe kemi ekspertizë të mjaftueshme për të bashkëpunuar si INCA dhe si Rrjet për Mbrojtjen e Natyrës.

Në konferencë u prezantua puna dhe roli i **Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës**, i krijuar në vitin 2013, me mbështetje të REC, në kuadër të programit SENiOR-A (Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri), financuar nga Qeveria Suedeze. Në përbërje të rrjetit janë INCA dhe shoqatat: Forumi i Liqenit të Shkodrës, Mbrojtja e Mjedisit-Kukës, Miqësia-Ulëz, PSEDA-ILIRIA-Tiranë, Adriatiku-Vlorë, Zagoria-Gjirokastrë dhe Green&Clean-Korçë. Qëllimi i kryesor i këtij grupimi ishte: -Forcimi i rolit të organizatave mjedisore të shoqërisë civile për ruajtjen e natyrës dhe rritjen e kontributit lokal në ruajtjen e ZM dhe ekosistemeve të ujërave të ëmbla e habitateve detare”; -Forcimi i bashkëpunimit midis organizatave të rrjetit dhe -Zhvillimi i traditave të qëndrueshme dhe mënyrave të reja për promovimin e vlerave lokale të zonave të mbrojtura dhe habitateve ujore.

Arritjet e këtij grupimi janë të shumëta dhe të sukseshme në nivel lokal dhe kombëtar. Tashmë ky grupim ka bërë historinë e vet lidhur me: - Rritjen e ndërgjegjësimit të komuniteteve lokale në çështjet e biodiversitetit; - Shkëmbimin e eksperiencave dhe ngritjen e kapaciteteve midis partnerëve; - Forcimin e rolit dhe pranisë së shoqatave në nivel lokal; - Krijimin, promovimin dhe zhvillimin shumëfunktional të PNR; -Përmirësimin e komunikimit dhe vizibilitetit në nivel kombëtar (website); -Përmirësimin e informacionit mbi vlerat natyrore dhe mundësitë e shijimit të tyre në Shqipëri; -Krijimin i database për rrjetin e ZM në Shqipëri dhe të parqeve kombëtare në veçanti; -Organizimin dhe festimin e ditëve mjedisore dhe ato lokale shpirtërore; -Krijimin e Fotogalerive e të videove; - Publikime të ndryshme duke filluar me “Ditari Natyrës”; -Pjesëmarrja me Panairët Kombëtare si ai i Trashëgimisë dhe Artizanatit apo ArgjiroFest\_ON në Gjirokastrë, etj.


E veçantë e grupimit ka qënë mënyra e komunikimit dhe e marrëdhënieve të ndërsjellta për realizimin e

programit të përgjithshëm dhe të planeve të punës vjetore, nëpërmjet organizimit të takimeve dhe të veprimtarive të përbashkëta. Puna dhe përkushtimi i treguar nga të gjitha shoqatat përbërëse është vlerësuar edhe për faktin se mjaft OJF mjedisore të tjera kanë kërkuar të njihen me përvojën në lidhje me krijimin dhe funksionimin e RrMN dhe realizimin e programeve.

Ai përbën histori suksesi, inovacioni, promovimi, ndërgjegjësimi, bashkëveprimi dhe menaxhimi të qëndrueshëm shumëfunktional të natyrës dhe ZM, fal punës së drejtuesve dhe stafeve të të gjitha shoqatave pjesëmarrëse, por edhe të mbështetjes së veçantë nga REC Albania dhe Ambasada e Suedisë.

Ka ardhur koha që MM, AKZM dhe gjithë aktorët të mendojnë se menaxhimi i ZM mund të bëhet mirë dhe madje, në disa raste, edhe më i efektshëm nëse përfshihen si duhet në këtë proces shoqëria civile, organizatat lokale apo rrjetet e ruajtjes së natyrës, që janë kompetentë në këtë fushë dhe komuniteti.

Rekomandimet dhe sugjerimet e dhëna nga pjesëmarrësit në Konferencë duhet të përfshihen në programet dhe planet vjetore të MM, AKZM dhe institucioneve të tjera shtetërore dhe të njëjstëve të reja të qeverisjes vendore, jo vetëm për dijeni, por si dokumentetë rëndësishëm për përmirësimin e situatës së menaxhimit të rrjetit të ZM të Shqipërisë. Gjithashtu, këto sugjerime mund të marrin vlerë dhe duhet të përdoren nga një rrjet më i gjerë njerëzish dhe shoqëria civile që janë përfshirë si aktorë në mbrojtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e ZM apo në zhvillimin e qëndrueshëm me pjesëmarrje të gjërë, efektiv dhe shumëfunktional të natyrës dhe ZM në Shqipëri.



Pariku Kombëtar Valbonë © Foto INCA

## Filloi hartëzimi i shtigjeve në ZMD Karaburun-Sazan


Karaburun, 31 Korrik 2015 – INCA në bashkëpunim me AdZM Vlorë, ekspertë dhe guida profesionale kombëtare, filluan hartëzimin e shtegut tokësor nga Orikumi në Gjirin e Bristanit në Karaburun.



Ky aktivitet po kryhet në kuadër të zbatimit të Projektit të Granteve të Vogla, pjesë e projektit të SEA-Med. Shtegu është rreth 8 km i gjatë, dhe fillon nga pjesa lindore e Gadishullit të Karaburunit, pranë bazës ushtarake Pashaliman, duke përfunduar deri te një nga gjiret më të bukura perëndimore të

gadishullit, Gjirin e Bristanit. Ndjekja e këtij shtegu nga turistët dhe dashamirësit e natyrës mund të kryhet në jo më shumë se tre orë në këmbë. Nga ekipi i ekspertëve do të propozohen tre shtigje dhe do të vendoset edhe infrastruktura e duhur dhe tabela informacioni.

Iniciativa e Granteve të Vogla është një grant nga WWF dhe UNDP. Fokusi kryesor i tij është mbështetja e bizneseve turistike të bazuara në natyrë të cilat veprojnë brënda parkut me infrastrukturë të qëndrueshme dhe eko-miqësore



© Foto AdZM Vlorë

## NJOFTIME

**16 Shtator - Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Ozonit**

**22 Shtator - Dita pa Makina**

**26 Shtator - Dita Ndërkombëtare e Shëndetit Mjedisor**

**27 Shtator - Dita Botërore e Turizmit**

1 - Për të lexuar “*Ditari i Natyrës*” në vite...

[http://www.inca-al.org/index.php?option=com\\_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=15&Itemid=195&lang=sq](http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=15&Itemid=195&lang=sq)

## Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

• Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

• Ky botim është mundësuar nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENIOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës / Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro